



NEW HORIZON
Civil Society Organization



QENDRA PËR PUNË SOCIALE
për komnat Tivar e Ulqin
Njësia rajonale Ulqin



ÇFARË PAS DIVORCIT

UDHËZUES PËR PRINDËRIT E VETËM

ÇFARË PAS DIVORCIT

Udhëzues për prindërit e vetëm

Botues:

OJQ "Horizonti i Ri"

rr. Kodre pn, 85360 Ulqin

E-mail: horizon@t-com.me

www.ngo-horizonti.org

 *newhorizonngo*

Redaktorë të publikimit:

Nazif Veliqi

Suela Avdiq

Udhëzuesin e përgatitën:

Renata Blenishta

Mehmet Duraku

Lirije Buzuku

Dizajni dhe përshtatja grafike:

Omer Muslica

Shtypi:

TRIO PRO Ulqin

Ulqin, 2017

Ky publikim është përgatitur në bashkëpunim me Qendën për punë sociale për komunitat Tivarit dhe Ulqin - Njësia Rajonale Ulqin.

**Botimin e këtij udhëzuesi e financoi KOMISIONI PËR
NDARJEN E FITIMIT NGA LOJËRAT E FATIT, nga fusha
e Mbrojtjes Sociale dhe Aktivitetëve Humanitare
(2016).**



HYRJE

Divorci dhe gjithçka që i paraprinë e që pason, është një fazë mjaft stresuese në të cilën kalojnë prindërit bashkë me fëmijët. Marrëdhëniet e përkeqësuara midis prindërve dhe konfliktet e tyre të shpeshta, jo rallë të shoqëruara me dhunë psikologjike e fizike nga njëri partner, rezultojnë në prishjen e qëndrueshmërisë mendore dhe krijimin e një atmosfere jo të favorshme familjare, të cilën më së shumti e vuajnë fëmijët.

Familja në komunitetin tonë ka tendencën e tipit modern-patriarkal. Si e tillë ajo është një mbështetje e fuqishme për zhvillimin demokratik të shoqërisë, me të gjitha shumëllojshmëritë e saj.

Si çdo shoqëri në tranzicion e në proces të integritimit, ashtu edhe komuniteti ynë lokal ballafaqohet me shumë probleme, veçanërisht në përshtatjen e tendencave moderne. Kjo kryesisht është e lidhur me familjen, mbështetja e së cilës është e nevojshme në të gjitha aspektet e jetës shoqërore.

Sipas të dhënave të MONSTAT-it nga regjistrimi i fundit, në Mal të Zi ekzistojnë 24,424 familje në të cilat fëmijët i rrit vetëm nëna dhe 5,105 familje në të cilat fëmijët i rrit vetëm babai, që do të thotë se gjithsej janë rreth 30 mijë familje me prindër të vetëm. Numri i fëmijëve që jetojnë vetëm me njërin prind ndoshta është dy here më i madh. Ky është një numër mjaft i madh për një shtet kaq të vogël, por kjo nuk është për tu habitur, duke pasur parasysh që numri i divorceve po rritet dita-ditës.

Numri i divorceve në Mal të Zi, sipas të dhënave të MONSTAT-it, është në rritje të vazhdueshme: nga 1000 martesë të lidhura 130 prej tyre përfundojnë me divorc.

Pozita dhe të drejtat e fëmijëve në procesin e divorcit, më së miri janë të definuara dhe të rregulluara me Konventën mbi të drejtat e fëmijës (miratuar më 20 Nëntor 1989 nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara), si dokument universal ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

ÇFARË DO TË THOTË TË JESH PRIND I VETËM?

Familja me të dy prindërit biologjikë, paraqet mjedisin më të favorshëm për zhvillimin intelektual, emocional dhe social të fëmijës. Gjendja e përgjithshme e shoqërisë globale ka shkaktuar ndryshime në strukturën familjare dhe një nga modelet gjithnjë e më të shpeshta të familjes, është edhe familja me një prind.

Familja me një prind - është ajo familje të cilën e përbëjnë fëmija/fëmijët dhe njëri nga prindërit.

Prind i vetëm - quhet personi i cili është i divorcuar ose kur prindi tjetër ka vdekur ose është i panjohur, që mban fëmijën respektivisht ushtron të drejtën e vazhduar prindërore, në përputhje me ligjin, deri me krijimin e bashkësisë martesore apo jashtëmartesore¹.

Ligji për Familjen i Malit të Zi² në nenin 78 përcakton thelbësisht kur një prind ushtron i vetëm të drejtën prindërore, kurse neni 79 përfshinë marrëveshjen për ushtrimin e të drejtës prindërore si edhe të drejtat dhe detyrimet e prindërit i cili nuk ushtron të drejtën prindërore.

Në botë problemi i prindërimit të vetëm zgjidhet përmes “rrjeteve” të këshillimit dhe shkollave për prindër. Për shembull, në Suedi, në Stokholm në çdo lagje të madhe ndodhen Qendrat Familjare ku specialistë të fushave të ndryshme (psikologë, punonjës social) punojnë në edukimin e familjeve me një prind.

Në Kroacinë fqinje përshembull, ndiqen dhe zhvillohen praktikat më të mira të vendeve tjera evropiane, duke hapur Qendra Familjare. Këto qendra punësojnë një ekip të tërë ekspertësh dhe themelojnë shkolla për prindërim të suksesshëm, të dedikuara të gjithë prindërve si mbështetje në përkujdesjen ndaj fëmijëve e veçanërisht në tejkalimin e problemeve personale. Sipas nevojave individuale në qendrat familjare realizohen edhe këshillime individuale për prindër. Prindërit e vetëm mund të themelojnë shoqata dhe në atë mënyrë të krijojnë rrjetin për mbështetje reciproke. Në këto shoqata prindërit fitojnë atë që e kanë më të rëndësishme - mbështetjen emocionale dhe miqësore, por gjithashtu shkëmbejnë edhe të mira materiale e shërbime.

1 Neni nr.10, Ligji për Mbrojtjen Sociale dhe të Fëmijëve, (“Fl. zyrtare e MZ”, nr. 27/2013)

2 Ligji për Familjen, (“Fl. zyrtare e RMZ”, nr. 1/2007)

Frika dhe shqetësimet e prindërve për fëmijët:

- *shqetësimet për sigurinë financiare të fëmijëve, tani dhe në të ardhmen;*
- *frika se mos fëmija do të “bie” në shoqëri të keqe, frika nga rreziqet e drogës, dhunës në rrugë dhe zgjedhjes të partnerit të keq;*
- *shqetësimi se si do të formohen fëmijët e tyre, si do të ballafaqohen me jetën;*
- *shqetësimet për shkollimin e tanishëm ose të mëvoshëm të fëmijës, për përballimin e shpenzimeve të shkollimit;*
- *frika nga pasojat negative emocionale të fëmijës, për shkak të mungesës të njërit prind në edukimin e tij;*
- *përafërsisht çdo i dhjeti prind i vetëm thekson se ka frikë se do të vdesë ose do të sëmuret para se fëmijët e tyre të jenë në gjendje të kujdesen për vetveten.*

Vështirësitë e prindërve të vetëm:

- *problemet financiare*
- *lodhja dhe mbingarkesa në punë*
- *fakti që duhet të marrin vetë përgjegjësinë për edukimin e fëmijëve*
- *brengosja e vazhdueshme për mënyrën e edukimit të fëmijëve dhe për të ardhmen e tyre*
- *mungesa e kontaktit apo kontakti i dobët i fëmijës me prindin tjetër*
- *papunësia ose punësimi i paqëndrueshëm*
- *vetmia dhe të ndjerit vetëm*
- *mospërputhja e orarit të punës me mundësinë për tu kujdesur për fëmijët*
- *pamundësia për t’i realizuar nevojat dhe dëshirat e fëmijëve*
- *t’iu shpjegojnë fëmijëve se ku është prindi tjetër*
- *mungesa e mirëkuptimit nga komuniteti*
- *problemet në realizimin e të drejtës për mbështetjen financiare të fëmijës (alimentacionit)*
- *çështja e parregulluar e strehimit*



Ç'MUND TË BËJNË PRINDËRIT E VETËM QË T'IA LEHTËSOJNË VETES JETEN E PËRDITSHME?

Mundohuni të koordinoheni me prindërit e tjerë të lagjes për transportin dhe ruajtjen e fëmijëve.

Nëse është e mundur, përpiquni të merreni vesh me punëdhënësin për të qëndruar në shtëpi kur fëmijët janë të sëmurë, por që atë ditë ta kompensoni (psh. të shtunën).

Organizoni ditën tuaj: prej mëngjesit deri në darkë. Ushqimi i rregullt dhe gjumi në kohën e caktuar do t'ju ndihmojë juve dhe fëmijët tuaj që të jeni më të shëndetshëm, por edhe t'i organizoni më mirë obligimet tuaja. Planifikoni paraprakisht çfarë do të bëni në qoftë se fëmijët kthehen nga shkolla më herët ose sëmuren, ndërsa ju duhet të punoni.

Si të përballeni me problemet?

Bisedoni me dikë. Mos hezitoni të kërkonti ndihmën e psikologut nëse nuk ndjeheni mirë. Të jesh i fortë do të thotë ta kërkojë dhe ta pranosh ndihmën atëherë kur ke nevojë.

Gjeni një grup mbështetje. Është e rëndësishme të diskutoni për situatën tuaj me dikë që ka pasur një përvojë të ngjashme. Komunikoni me prindërit e tjerë të vetëm nga mjedisi ku jetoni, nga shkolla e fëmijës, etj.

Vendosni paraprakisht shpërblimet dhe dënimet për fëmijën (sigurohuni që të gjithë anëtarët e familjes t'i dinë rregullat dhe t'i pranojnë ato).

Shmangni ndëshkimin fizik të fëmijëve. Në vend të këtij ndëshkimi përdorni pasojat logjike (psh. nëse fëmija e thyen lodrën e tij, ai e vërenë se nuk e ka më atë lodër; ose nëse derdh diçka, duhet ta pastrojë atë; ose nëse nuk e vesh pallton, ai do të ketë ftohtë); dhënien apo heqjen e privilegjeve (psh. shpërblim mund të jetë shikimi i emisionit të preferuar, interneti, ëmbëlsirat, kurse heqja e këtyre privilegjeve do të jetë dënimi). Në këtë mënyrë do të jeni më konsekuent dhe efektiv në edukimin e fëmijës.

Parashikoni paraprakisht reagimin tuaj në situatat shqetësuese. Planifikoni që më herët çfarë do të thoni dhe çfarë do të bëni nëse psh.

prindi tjetër, me ardhjen e tij të pa paralajmëruar, ndërpret planet tuaja ose me mosardhjen e tij e zhgënjen fëmijën. Mundohuni të gjeni një përgjigje që nuk i përfshinë fëmijët në problem dhe **MOS I DETYRONI FËMIJËT QË TË MBAJNË ANË.**

Nëse miqtë dhe të afërmit tuaj vazhdimisht ju kritikojnë, mendoni se si do të reagoni që ta ndërprisni atë lloj diskutimi. Mos lejoni që t'ju përfshijnë në diskutime të tilla në të cilat duhet t'iu jepni llogari, veçanërisht jo para fëmijës. Nëse nuk jeni të sigurt që po veproni si duhet, më mirë bisedoni me një specialist.

Kontrolloni reagimet tuaja emocionale ndaj fëmijëve. Respektoni personalitetin e fëmijëve tuaj. Fëmijët nuk janë pronë e askujt, pra as e juaja. Duhet të jeni të vetëdijshëm që disa vese të tyre mund t'ju përkujtojnë në ish-partnerin tuaj e kjo t'ju bënë më kritik ndaj fëmijës se sa do duhej të jeni. Kjo sjellje mund të çojë në neglizhimin emocional të fëmijës (psh. je kokëfortë mu si babai yt dhe e di mirë që këtë ves unë e urrej).

Ndiqui hobin tuaj apo gjeni një hobi të ri. Kjo do t'ju ndihmojë, nëse gjeni të paktën një gjë që ju mund të bëni për veten tuaj e të ndjeheni mirë. Hobi juaj mund të jetë vrapimi, leximi, vizatimi, noti, etj.

Dilni herë pas here me shoqërinë. Organizoni ruajtjen e fëmijëve me prindërit e tjerë të vetëm, në mënyrë që kohë pas kohe të vizitoni miqtë e të argëtoheni. Duhet të gjeni kohë që të shoqëroheni edhe me njerëz të moshës suaj. **Prindi i kënaqur është prind më i mirë.**



Anët pozitive të të qenit prind i vetëm

- mungesa e përvojave negative martesore
- kënaqësia që jeni të lirë dhe të pavarur të merrni vendime që ju takojnë juve dhe fëmijëve tuaj
- kënaqësia që fëmijët formohen si individë të mirë e të lumtur
- afërsia dhe besimi në mes të prindit dhe fëmijëve
- mbështetja e njerëzve të afërt në mjedisin ku jetoni

PESË KËSHILLA PËR PRINDËRIT E VETËM

Mbani mend, ju jeni prind

Pa marrë parasysh situatën, ju ende jeni një familje edhe pse në bashkësinë tuaj familjare mungon njëri prind. Shumë familje me prindër të vetëm funksionojnë në mënyrë të përkryer dhe janë emocionalisht të shëndetshme. Ky nuk është fat, por një zgjedhje që ju vetë e bëni. Kjo familje ka vendosur të jetë e shëndetshme, e lumtur, e mbushur me hare dhe me ndjenja pozitive.

Këshillë: Mendoni për disa ideale me të cilët familja juaj dëshiron të identifikohet dhe shënoni ato. Gjithashtu mund t'i ngjitni në frigorifer ose në anën e brendshme të derës së shtëpisë. Le t'ju përkujtojnë këto shënime në qëllimin tuaj, kur të jeni në vështirësi.

Flisni me fëmijën tuaj për ndjenjat e tij

Siç e dini, edhe fëmija juaj e përjeton ndjenjën e humbjes. Pavarësisht nga moshja, fëmija juaj mund të ndihet i trishtuar, i zemëruar apo thjesht të ndihet ndryshe nga moshatarët e tij. Lëreni fëmijën tuaj të flasë për ndjenjat e tij. Kjo do ta bëjë marrëdhënien tuaj më të fortë.

Këshillë: Gjeni momentet kur fëmija juaj vërtetë ju dëgjon. Shfrytëzoni këto momente që të jenë sa më tërheqëse dhe të kenë dobi reciproke. Çastet e tilla janë shumë të rralla në jetën e prindit me fëmijën adoleshent.

Jini të gatshëm

Përfshihuni në jetën e tyre sa më shumë që të mundeni. Tregojini atyre që jeni besnik ndaj familjes pavarësisht nga stresi dhe humbja.

Këshillë: Merrni pjesë në aktivitetet shkollore të fëmijës suaj. Gjeni të gjitha ato gjëra që mundeni apo duhet t'i kryeni së bashku. Hani mëngjesin, drekën dhe darkën së bashku. Dilni së bashku për ecje në mëngjes apo mbrëmje.

Mësojini fëmijëve përgjegjësitë e tyre

Adoleshentët zakonisht i lusin prindërit për të qenë të pavarur. Mënyra më e mirë që t'iu mësoni përgjegjësitë është duke iu dhënë atyre të kryejnë punë të thjeshta shtëpiake. Mos i shihni këto punë si diçka me


të cilat do t'i lodhni fëmijët tuaj, por si mundësi që fëmija juaj në atë moshë të tregojë përgjegjësi, pra të dëshmojë që di ta vlerësojë dhe shfrytëzojë pavarësinë e tij.

Këshillë: Filloni me punë që kërkojnë më pak përgjegjësi dhe gradualisht jepini punë me përgjegjësi më të madhe.

Jetoni sipas mënyrës tuaj dhe brenda mundësive

Prindërit shpesh hyjnë në borxhe të mëdha në mënyrë që të “kujdesen” për fëmijën. I blejnë fëmijës rroba “firmato”, makinë si dhe sende që fëmija mendon se i nevojiten. Në këtë mënyrë adoleshenti nuk do të mësojë vlerën e vërtetë të parasë ndërsa borxhet prindërve do t'iu sjellin krizë financiare.

Këshillë: Mësojeni fëmijën tuaj që t'i shpenzojë paratë në mënyrën e duhur. Në qoftë se e ka moshën e punësimit, lëre të gjejë punë dhe t'i mbulojë shpenzimet e tij me pagën që merr. Lejojeni që një herë apo dy të mësojë nga gabimet e veta.



ASPEKTET FAMILJARO-JURIDIKE TË DIVORCIT

Çështjet lidhur me mosmarrëveshjet martesore në Mal të Zi janë të rregulluara me *Ligjin për Familjen dhe Ligjin mbi Procedurën Civile*³. Një shembull tipik i kontestit martesor është mosmarrëveshja që rrjedh si pasojë e divorcit. Akti fillestar me të cilin iniciohet procedura e divorcit mund të jetë padia për divorc apo propozimi për një divorc “miqësor”. Në rast se procesi gjyqësor për shkurorëzim iniciohet me padi, bashkëshortët mund të kërkojnë divorc nëse marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht dhe përgjithmonë ose në rast kur për shkaqe tjera nuk mund të arrihet qëllimi i martesës.

Në rastin tjetër, kur procedura është iniciuar me propozimin për një divorc “miqësor” është e nevojshme që bashkëshortët të bëjnë një marrëveshje në formë të shkruar për ushtrimin e të drejtave prindërore dhe ndarjen e pasurisë së përbashkët. Gjatë procedurës së divorcit, gjykata është e detyruar të bashkëpunojë me organin e kujdestarisë dhe shërbimet tjera profesionale që merren me çështjen e martesës dhe familjes, veçanërisht kur bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët të mitur⁴.

Pasojat e divorcit në:

- *marrëdhëniet personale të bashkëshortëve*

Ligji nuk parasheh asnjë pasojë divorci për marrëdhëniet personale të bashkëshortëve.

- *ndarjen e pasurisë*

Divorci sjell ndarjen e pasurisë së përbashkët. Bashkëshortët, në aspektin e Ligjit për Familjen, mund të ketë pronë të ndarë dhe të përbashkët. Prona individuale është pronë që bashkëshorti e ka fituar para martesës si edhe prona e fituar gjatë martesës me trashëgimi, dhuratë apo në ndonjë mënyrë tjetër juridike. Secili bashkëshort në mënyrë të pavarur menaxhon dhe disponon pronën e veçantë (të tij), nëse bashkëshortët nuk kanë rënë dakord ndryshe.



3 Ligji mbi Procedurën Civile (“Fl. zyrtare e RMZ”, nr. 22/2004 dhe 76/2006)

4 Neni 336 Ligji për Familjen në MZ

Bashkëshortët mund të ndajnë në mënyre miqësore pasurinë e përbashkët, ashtu që të caktojnë disa pjesë nga e tërë pasuria ose një pjesë të pasurisë ose ndonjë gjë individuale, ku secilit i takojnë sendet e caktuara ose të drejtat nga kjo pasuri; ose njëri bashkëshort i paguan tjetrit vlerën monetare të pjesës së tij. Marrëveshja duhet të bëhet me shkrim⁵. Nëse bashkëshortët nuk bien dakord për ndarjen e pasurisë së përbashkët, prona e bashkëshortëve ndahet në pjesë të barabarta. Me kërkesë të njërit bashkëshort i cili dëshmon se kontributi i tij për fitimin e pasurisë së përbashkët është dukshëm më i madh se kontributi i bashkëshortit tjetër, gjykata do ta ndajë pasurinë e përbashkët në përputhje me kontributin e secilit prej tyre.

- *në ushtrimin e të drejtës prindërore*

Kur është fjala për procedurën që ndiqet sipas padisë për divorc, në aktvendimin e gjykatës me të cilin martesë prishet, gjykata duhet të vendosë për ushtrimin e të drejtës prindërore. Nëse procedura gjyqësore e divorcit iniciohet me propozimin për divorc “miqësor”, pjesë përbërëse e këtij propozimi duhet të jetë edhe marrëveshja për ushtrimin e të drejtës prindërore. Prindërit mund të bien dakord që të drejtën prindërore ta ushtrojnë bashkë apo individualisht dhe gjykata do ta pranojë këtë marrëveshje, nëse konstaton se kjo është në interesin më të mirë të fëmijës.

- *vendimin për divorc*

Vendimi i gjykatës me të cilin është shkurorëzuar martesë sipas propozimit të bashkëshortëve për divorc “miqësor”, mund të kundërshtohet vetëm në rast shkelje të rregullave të procedurës civile, ose për shkak se propozimi është dhënë gabimisht, ose nën ndikimin e forcës, ose mashtrimit⁶.

Në qoftë se me vendimin përfundimtar martesë është prishur ose anuluar, nuk mund të përdoren mjete të jashtëzakonshme juridike për të ndryshuar vendimin për shkurorëzim, pavarësisht nëse njëra palë ka hyrë në një martesë të re.



5 Neni 293 Ligji për Familjen

6 Neni 343, 344 Ligji për Familjen

ALIMENTACIONI (DETYRIMI FINANCIAR), SI TA PËRFITJMË?

Kontributi financiar (alimentacioni) si term paraqet obligimin e një personi që të sigurojë nevojat bazë të jetesës, edukimin dhe nevojat tjera të personit tjetër. Legjislacioni mbi këtë temë është më se i qartë, megjithatë kur është fjala për zbatimin e ligjit në praktikë, për shkak të situatave të shumta ligji shtynë kufijtë dhe është i prirur ndaj situatave konkrete individuale.

Procedura gjyqësore për realizimin e alimentacionit, është procedurë e veçantë gjyqësore, e cila është kryesisht e standardizuar me Ligjin për Familjen, pastaj me ligjin për Procedurën Civile, respektivisht me dispozitat që rregullojnë procedurën e përgjithshme gjyqësore. Ka shumë raste kur palët ndahen me mosmarrëveshje dhe kur, për shumën e alimentacionit nuk mund të flitet pa praninë e një autoriteti më të lartë (gjykata, avokati).

Ligji⁷ përcakton shumën e mbështetjes financiare për fëmijën, e cila sipas rregullit nuk duhet të jetë më pak se 15% e as më shumë se 50% e të ardhurave mujore të personit të detyruar për dhënien e detyrimit financiar. Në qoftë se personi që duhet të marrë mbështetjen financiare është fëmija, shuma e kësaj mbështetjeje duhet të sigurojë minimalisht standard të tillë jetese për fëmijën, të tillë siç e gëzon edhe prindi detyruar për dhënien e mbështetjes financiare.

Procedurat për kontributin financiar iniciohen me anë të një padie (kërkese) të cilën mund ta paraqesë një fëmijë i mitur ose prindi, si përfaqësues i tij ligjorë. Gjithashtu, organi i kujdestarisë, në emër të fëmijës së mitur mund të nisë procedurën për alimentacion, respektivisht për rritjen e kësaj mbështetjeje financiare, në qoftë se prindi të cilit i është besuar përkujdesja dhe edukimi i fëmijës, nuk e ushtron këtë të drejtë për shkaqe të pajustificueshme. Nëse prindi nuk kërkon zbatimin e vendimit për mbështetjen financiare të fëmijës, atëherë përmbaruesi publik, në emër të fëmijës së mitur, do t'i paraqesë gjykatës propozimin për zbatimin e vendimit gjyqësor, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore. Gjykata është e detyruar që secilin

7 Neni 281 Ligji për Familjen i MZ

vendim për mbështetjen financiare t'ia dorëzojë organit kompetent të kujdestarisë. Pasi që, mbështetja financiare përcaktohet në përputhje me nevojat e personit që kërkon mbështetje dhe në proporcion me mundësitë e personit i cili ka për detyrë të mbështesë financiarisht, ndodh që për shkak të shfaqjes ose ndërprerjes së fakteve që lidhen me alimentacionin, detyrimi i përcaktuar më herët bëhet i pamjaftueshëm ose i panevojshëm.

Ndryshimi i detyrimit të mbështetjes financiare, i dhënë nga gjykimi i mëhershëm, lejohet vetëm që mbështetja financiare të plotësojë qëllimin e përcaktuar me ligj. Në proceset gjyqësore, në mënyrë pasive legjitimohen prindërit ose persona të tjerë, të cilët me ligj janë të detyruar që të mbështesin financiarisht fëmijën, në qoftë se fëmija nuk e gëzon këtë mbështetje nga prindërit.

Për mosmarrëveshjet për mbështetjen financiare janë kompetente (si gjykata të shkallës së parë) gjykatat themelore. Kur është fjala për kompetenca territoriale, prokurorit i është dhënë e drejta për të zgjedhur gjykatën kompetente, që në mënyrë të konsiderueshme lehtëson statusin e tij në proces. Kështu prokurori, përveç gjykatës kompetente ose gjykatës në territorin e së cilës i pandehuri banon ose vetëqëndron, mund t'i drejtohet edhe gjykatës ku ai ka vendbanimin e tij të përhershëm apo të përkohshëm.

Procedura për ekzekutimin e detyrueshëm

Duke miratuar vendimin përfundimtar për alimentacion, nuk do të thotë se është arritur edhe dhënia e kësaj mbështetje financiare. Shpeshherë, detyruesi shmang që me dëshirë të kryej detyrën e tij, kështu që realizimi i këtij vendimi bëhet me forcë, në pajtim me dispozitat e *Ligjit për Përmbarrim dhe Siguri*⁸. Sipas këtij ligji, përmbarruesit publik i është besuar përgjegjësia e vendimmarrjes në procedurën për zbatimin dhe ekzekutimin e vendimit të gjykatës. Një rregull i tillë hedh poshtë modelin e mëparshëm të ekzekutimit gjyqësorë dhe kontribuon për një ekzekutim më efikas, procedura më të shpejta dhe më të shkurta, zvogëlimin e numrit të lëndëve, etj. Të gjitha këto kanë të bëjnë me të drejtën për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, e cila është një nga të drejtat themelore të garantuara me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

8 ("Fl. zyrtare e RMZ", nr. 36/11)

Sipas Ligjit për Familjen, përveç personave që janë të legjitimuar (sipas dispozitave të Ligjit për Përmbardim dhe Siguri) për të filluar këtë procedurë, procedura e zbatimit mund të iniciohet edhe nga organi kujdestarisë në emër të fëmijës së mitur, nëse prindi nuk kërkon zbatimin e vendimit me të cilin është dhënë alimentacioni. Zbatimi i vendimit përcaktohet në bazë të titullit ekzekutiv, respektivisht të vendimit të plotfuqishëm të gjykatës.

Me kërkesën e palës, gjykata vendos konfirmimin zyrtar për kushtet e zbatueshmërisë së vendimit të sjellë. Një nga karakteristikat e afateve në procedurën e zbatimit është se, për shkak të procedurës urgjente, afatet janë të shkurtë si për gjykatën ashtu edhe për pjesëmarrësit në procedurë.

Shpenzimet që lidhen me përcaktimin dhe zbatimin e vendimit, sipas rregullit i përballon detyruesi i alimentacionit. Lëndë të ekzekutimit janë sendet dhe të drejtat në të cilat sipas ligjit mund të realizohet ekzekutimi/përmbardimi (sendet materiale, pasuritë e patundshme, të ardhurat, fondet në llogarinë e detyruesit, etj). Vendimi i gjykatës është i ekzekutueshëm nëse ai është bërë i plotfuqishëm dhe nëse ka kaluar afati për përmbushje vullnetare të obligimit të detyruesit.

Vepra penale e mosdhënies së alimentacionit

Vepra penale e mosdhënies së alimentacionit është një nga krimet kundër martesës dhe familjes, të parashikuara nga Kodi Penal i Malit të Zi.

Mosdhënia e alimentacionit si një vepër penale ka dy forma - formën themelore dhe të rëndë. Veprimi i kryerjes së formës themelore të kësaj vepre penale është mosdhënia e alimentacionit, të përcaktuar me vendim të prerë të gjykatës ose me shlyerje në gjykatë ose në një organ tjetër kompetent, në shumën dhe mënyrën e përcaktuar me vendim të gjykatës. Akti i përmbardimit realizohet edhe në rastin kur alimentacioni nuk paguan shumën e plotë të përcaktuar me vendim të gjykatës. Forma e kualifikuar e veprës penale bëhet atëherë kur ka pasoja të rënda për përfituesin e alimentacionit. Ligji nuk specifikon se cilat janë këto pasoja të rënda, por ia lë gjykatës t'i vlerësojë ato. Në përgjithësi, pasoja të rënda konsiderohen përsëmbull: pamundësia për shkollim, përkeqësimi i shëndetit e të ngjashme. Për të parën - formën e lehtë të

veprës penale dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit. Ndërsa për të dytën - formën e rëndë të veprës penale, përcaktohet vetëm dënimi me burgim prej tre muaj deri në tre vite.

Ligji lejon mundësinë që gjykata krahas dënimit me kusht të detyrojë shkelësin për të paguar borxhin e përlloritur.

Mosveprimi sipas këtyre detyrimeve mund të jetë bazë për heqjen e dënimit me kusht. Për ekzistimin e një vepre penale është e nevojshme që detyrimi për mbështetje financiare të jetë i konkretizuar me vendim të gjykatës ose me shlyerjen ekzekutive në gjykatë. Parakushti i dytë për ekzistencën e veprës penale është qëllimi i kryerësit. Nëse kryerësi për shkaqe të arsyeshme nuk ka dhënë mbështetjen financiare, ligji parashikon qartë se vepra penale nuk do të ekzistojë. Ligji nuk përcakton se cilat janë këto arsye legjitime, por ia lë gjykatës në vlerësim. Qëllimi kryesor i procedurës penale për veprat penale të mosdhënies së alimentacionit, është ndikimi në një person për të paguar detyrimin e prapambetur për alimentacion dhe që në të ardhmen t'i paguaj me rregull, sepse kjo është në interesin më të mirë të të dëmtuarit e që me vendim gjykate ka të drejtë ta përfitojë atë.



MBAJTJA E RAPORTEVE TË FËMIJËS ME PRINDIN ME TË CILIN NUK JETON NË BASHKËSINË FAMILJARE

Në rast kur prindërit jetojnë të ndarë, ato bien dakord se ku do të jetojë fëmija. Nëse prindërit nuk kanë arritur në një marrëveshje ose nëse marrëveshja e tyre nuk është në interesin më të mirë të fëmijës, gjykata pasi të ketë dëgjuar mendimin dhe propozimin e organit të kujdestarisë (Qendrës për Punë Sociale) dhe të ketë shqyrtuar të gjitha rrethanat, do të vendosë se nën kujdesin dhe edukimin e cilit prind do të jetë fëmija, ose mund të vendos që disa fëmijë të rrinë tek nëna dhe disa tek babai, ose t'i besohen një pale të tretë, gjegjësisht një organizate.

Çfarë ndodh nëse partneri juaj kufizon ose pengon kontaktet tuaja me fëmijën?

Nëse kjo ndodh pas marrjes së vendimit të prerë për divorc është e nevojshme që në formë të shkruar të njoftoni Qendrën për Punë Sociale, e cila mund ta ftojë prindin tjetër dhe të përpiqet ta bindë që ai ta respektojë vendimin e gjykatës. Ndalimi ose moslejimi i kontaktit me fëmijët mund të konsiderohet si një shkelje e rëndë e të drejtave prindërore e që për pasojë mund të ketë nisjen e procedurës gjyqësore për heqjen e pjesshme ose të plotë të të drejtës prindërore.

Si mund t'iu ndihmojë Qendra për Punë Sociale nëse partneri juaj pengon kontaktet tuaja me fëmijën dhe në çfarë afati kohor duhet ta bëjë këtë? Çfarë duhet të bëni ju që Qendra t'ju ndihmoj?

Qendra për Punë Sociale mund të jap masën për mbrojtjen familjare e në raste të rënda informon Prokurorinë e Shtetit. Duhet të dorëzoni një kërkesë me shkrim në të cilën tregohet se kur dhe si ish-partner juaj ju ka ndaluar kontaktet me fëmijën. Procedura për këtë çështje është urgjente. Gjithashtu, vet prindi mund t'i kërkoj gjykatës ta ndryshoj vendimin.

A ka informacion Qendra për Punë Sociale se sa përqind e fëmijëve pas divorcit të prindërve humbasin kontaktet me njërin prind, pas divorcit të tyre? A ndihmon Qendra në këto raste dhe si?

Qendrën për Punë Sociale nuk mban evidencë për këtë. Qendra ndihmon atëherë kur fëmija ka humbur kontaktin me prindin tjetër, pra kur ky prind informon Qendrën për Punë Sociale se prindi të cilit i është besuar fëmija ndalon takimet dhe shoqërimet e tij me fëmijën. Nëse interesi i prindit tjetër për fëmijën mungon, Qendra nuk ka asnjë mënyrë që atë prind ta detyrojë të mbajë kontakt me fëmijën e tij.

A DUHET QË TË DY PRINDËRIT TË VENDOSIN PËR ÇËSHTJET MË TË RËNDËSISHME PËR FËMIJËT E TYRE?

Prindi të cilit nuk i është besuar fëmija, ka të drejtë të mbajë raporte personale me fëmijën dhe të marrë pjesë në marrjen e të gjitha vendimeve të rëndësishme që lidhen me të (zgjedhja e profesionit, shkollimi, trajtimi mjekësor, ndërrimi i vendbanimit, ikja jashtë shtetit, etj). Përmes organit të kujdestarisë (Qendra për Punë Sociale) një prind i tillë mund të ndalojë nxjerrjen e fëmijës jashtë shtetit.

Prindi të cilit nuk i është besuar fëmija, ka të drejtë gjithashtu të bëjë vërejtje ndaj veprimeve të caktuara dhe vendimeve të prindit me të cilin jeton fëmija e që kanë të bëjnë me sjelljet e tij të përgjithshme.

Në të gjitha këto situata vendimet i merr Qendra për Punë Sociale si organ kujdestarie. Gjykata ka mundësi përsëri që të rregullojë mënyrën e mbajtjes së raporteve të prindërve me fëmijët, me mendimin paraprak të organit të kujdestarisë, nëse këtë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara, pa marr parasysh nëse për këtë çështje më herët ka vendosur gjykata apo organi i kujdestarisë.

A duhet që “dhunuesit” t’i mundësohet mbajtja e marrëdhënieve me fëmijët?

Çfarë ndodh nëse prindi të cilit nuk i është besuar fëmija, është i dhunshëm ose fëmija e ka frikë?


Në këtë rast takimi me prindin e dhunshëm organizohet në Qendrën për punë sociale, në praninë e psikologut ose një punonjësi social, me propozim të arsyetuar të prindit me të cilin jeton fëmija. Mbajtja e marrëdhënieve të fëmijës me prindin mund të kufizohet ose ndalohet përkohësisht, vetëm për mbrojtjen e shëndetit dhe interesave të tjera të rëndësishme të fëmijës.

Çfarë ndodh nëse partneri juaj shpif dhe tenton që ta largojë fëmijën nga ju?

Në këtë rast mund të kërkohet (me shkrim) ndërhyrja e Qendrës për Punë Sociale. Nëse Qendra nuk arrin që këtë sjellje ta ndalojë, pasi kjo konsiderohet si abuzim emocional i fëmijës, prindi të cilit nuk i është besuar fëmija udhëzohet në Konsulencë Zhvillimore (në raste kur janë të çrregulluara në mënyrë drastike). Gjithashtu është e mundur të kërkohet ndryshimi i vendimit të gjykatës se me cilin prind do të jetojë fëmija.

Çfarë nëse familja e partnerit tuaj shpif për ju?

Edhe në këtë rast është e mundur që me shkrim të kërkoni ndërhyrjen e Qendrës për Punë Sociale, me çrast qendra thërret prindërit për të biseduar dhe pas kësaj vendos nëse është e nevojshme të kontaktohen anëtarët e tjerë të familjes. Nëse ndërhyrja e Qendrës për Punë Sociale nuk ndihmon atëherë procedura është e njëjtë si në rastin e mëparshëm.



SI T'I NXIRRNI DOKUMENTET E UDHËTIMIT PËR FËMIJËT? KUJT T'I DREJTOHENI?

Lëshimi i dokumenteve të udhëtimit është i rregulluar nga një ligj i vetëm në tërë territorin e Malit të Zi, *Ligji për Dokumentet e Udhëtimit*⁹. Ky ligj përcakton se për një person nën 18 vjeç ose një person të paaftë, kërkesën e paraqet njëri prind, krahas pëlqimit me shkrim të prindit tjetër, ose të përfaqësuesit ligjorë në përputhje me ligjin. Personi mund të udhëtojë në një vend tjetër nëse ka miratimin e njërit prind ose të një përfaqësuesi tjetër ligjorë në përputhje me ligjin¹⁰. Pëlqimi i prindit tjetër është i përshkruar me të njëjtin ligj:

“Kur të drejtat prindërore i ushtron njëri prind, kërkesën për lëshimin e dokumenteve për udhëtim në një shtet tjetër për një person nën 18 vjeç, e dorëzon prindi të cilit i është besuar ruajtja dhe edukimi i fëmijës, krahas pëlqimit me shkrim të prindit tjetër. Në qoftë se prindi tjetër kundërshton dhënien e dokumenteve të udhëtimit, respektivisht udhëtimin në një shtet tjetër, Ministria përkatëse reagon në mënyrën e përcaktuar me rregulloren për ushtrimin e të drejtës prindërore.”



9 Ligji është shpallur në “Fl. zyrtare të MZ”, nr. 21/2008, 25/2008 dhe 39/2013

10 Neni 26 dhe 27 i Ligjit Për Dokumentet e Udhëtimit

INTERESI MË I MIRË I FËMIJËS GJATË PROCESIT TË DIVORCIT DHE PAS TIJ

Fëmija është një qenie në zhvillim, kështu që aftësitë, nevojat dhe interesat e tij vazhdimisht ndryshojnë. Ajo që është në interesin e tij aktual, nuk do të jetë edhe interesi i tij afatgjatë.

Përcaktimi i interesit më të mirë të fëmijës bëhet në bazë individuale, duke marrë parasysh kontekstin në të cilin merren vendimet dhe rrethanat që ekzistojnë në anën e secilit fëmijë dhe secilit prind. Me një kujdes dhe vëmendje të veçantë, duke përdorur kritere objektive dhe subjektive, duhet të përcaktohen jo vetëm interesat e tashme por edhe interesat e ardhshme të fëmijës si dhe pasojat që do të ketë vendimi në të ardhmen e afërt e të largët të fëmijës.



Në mungesë të bashkëpunimit mes prindërve, organet kompetente nuk mund të përjashtohen nga detyrimi për të marrë të gjitha masat e mundshme për të siguruar mbajtjen e lidhjeve familjare. Pra duhet të marrin masa praktike për të inkurajuar prindërit të marrin pjesë në terapinë familjare; ose, që të arrijnë së marrëveshjen për kontaktin fillestar, të bëjnë përpjekjet e duhura dhe efektive për realizimin e të drejtës për kontakt.

Në rrethanat konkrete të secilit rast në nivel shtetëror, duhet të merren masa për të lehtësuar zbatimin e vendimit. Masa e cila do të merret, do të jetë e përshtatshme vetëm nëse zbatohet shpejt, pasi “kalimi i kohës mund të ketë pasoja të pakthyeshme” në marrëdhënien mes fëmijës dhe prindit me të cilin ai nuk jeton.

Në qoftë se mirëqenia dhe interesi më i mirë i fëmijës e kërkon këtë, kontakti me prindin tjetër duhet të lejohet edhe nëse prindi me të cilin fëmija jeton e kundërshton këtë. Gjithashtu, nëse është në interes të fëmijës edhe nëse me këtë shkelet e drejta e respektimit të jetës familjare të prindit, kontaktet jo vetëm që mund por edhe duhet të ndalohen ose të pengohen.

Gjatë marrjes së vendimit, organet shtetërore duhet të krijojnë një balancë të interesave të fëmijës dhe të prindit të tij, përndryshe duhet t'i japin përparësi interesave të tashme dhe të ardhme të fëmijës. Nëse kjo është e mundur, organet duhet të përpiqen që interesin e fëmijës ta mbrojnë në ndonjë mënyrë tjetër në vend të ndalimit të kontakteve,



me çka do të sigurohej arritja e qëllimit të kontakteve dhe shmangia e shkeljes të të drejtave prindërore për respektimin e jetës familjare. Në fushën e të drejtës familjare, për fëmijën është më e rëndësishme që ky interes të sigurohet gjatë ushtrimit të kujdesit prindëror, sidomos kur prindërit nuk jetojnë së bashku. Fakti që ata nuk jetojnë më së bashku, nuk duhet të pengojë plotësimin e të gjitha nevojave të fëmijës së tyre si dhe mbrojtjen e interesave të tij. Varësisht se çka përcaktohet si interesi më i mirë i fëmijës, organi kompetent duhet të zgjedhë një nga variantet: kujdestarinë e vetme ose të përbashkët.

Interesi më i mirë i fëmijës kërkon ndërhyrje të menjëhershme.

Dështimi për të vepruar në përputhje me parimin e urgjencës, si në vendimmarrje ashtu edhe në zbatimin e detyrueshëm të tij, bën që interesi më i mirë i fëmijës të mbetet i porealizuar dhe në të njëjtën kohë të shkelet e drejta e prindërve për respektimin e jetës familjare dhe e drejta për gjykim të drejtë.



NË VEND TË KONKLUZIONIT

Kur prindi është mendërisht, emocionalisht, shoqërisht i ekuilibruar; në mënyrë adekuate arrinë të përmbushë nevojat e fëmijës dhe me sukses e ndjek atë në të gjitha fazat e rritjes së tij, jeta me një prind të vetëm do të sigurojë një zhvillim të shëndetshëm mendor, fizik, emocional, intelektual e shoqërorë të fëmijës.


Sa kohë do të zgjas pranimi i situatës së re pas divorcit, varet nga moshë dhe gjinia e fëmijës si dhe sjelljes së prindërve ndaj tij.

Dashuria, vëmendja, kujdesi dhe pjesëmarrja në aktivitetet e përditshme si dhe interesimi i prindërve për ngjarjet, nevojat dhe ndjenjat e fëmijëve të tyre, janë thelbësore në këtë situatë.





NEW HORIZON
Civil Society Organization

OJQ "Horizonti i Ri"
rr. Kodre pn, 85360 Ulqin
E-mail: horizon@t-com.me
www.ngo-horizonti.org
 [newhorizonngo](https://www.facebook.com/newhorizonngo)